



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-**

NJOFTIM PER MEDIA

Prezantohet në detyrë Kryetarja e Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës.

Me Vendimin Nr. 96/2016 datë 22.12.2016 të Kuvendit të Shqipërisë, Znj. Juliana Latifi zgjidhet Kryetare e Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës. Ajo zëvendëson Znj. Lindita Milo (Lati), të cilës i përfundoi mandati. Znj. Juliana Latifi mban titullin shkencor “Prof.Dr.”. Me një kapacitet dhe përvojë të gjerë profesionale-akademike në fushën e së drejtës civile dhe në atë të konkurrencës, Znj Latifi do të udhëheqë Autoritetin e Konkurrencës në pesë vitet e ardhshme. Në profesionin e saj, për rreth 22 vjet, spikat një përvojë e pasur akademike dhe profesionale, për më shumë se 18 vjet ajo është pjesëtare e trupës akademike, si pedagoge dhe titullare e disa lëndëve në fushën e së drejtës private: E Drejta Civile; E Drejta e Shoqërive Tregtare; E Drejta e Konkurrencës dhe Falimentimit, etj., në universitetet publike dhe ato private në Shqipëri si dhe pedagoge pranë Shkollës së Magjistraturës, dekanë në disa institucione të Arsimit të Lartë. Ajo është autore edhe e disa librave, në fushën e së drejtës civile, të cilat janë pjesë përbërëse e programeve zyrtare të universiteteve publike dhe private, si dhe të Shkollës së Magjistraturës, anëtare e disa bordeve akademike shkencore ndërkombëtare, konsulente ligjore në projekte të ndryshme ndërkombëtare, botimin e një sërë artikujve në fushën e së drejtës civile në revista shkencore kombëtare e ndërkombëtare.